

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2007

ABSTRAKT

Në këtë material është analizuar ecuria e investimit të huaj direkt në Shqipëri gjatë vitit 2007, duke u bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga vrojtimi mbi kompanitë me kapital të huaj e të përbashkët, zhvilluar gjatë korrikut të vitit 2008.

1. HYRJJE

Investimet e Huaja Direkte (IHD)¹ në Shqipëri vazhdojnë të jenë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit si edhe një nga burimet kryesore për financimin e deficitit të llogarisë korente. Njohja e vlerës së saktë dhe natyrës së IHD-ve nënvizon nevojën për statistika të sakta dhe të detajuara në lidhje me to. Matja dhe regjistrimi i IHD-ve në vendin tonë mbetet një sfidë për ofrimin e statistikave cilësore dhe të krahasueshme në vite dhe me ato të vendeve të tjera. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT ka ndërmarrë vrojtme të përvitshme pranë kompanive me kapital të huaj e të përbashkët, që operojnë në Shqipëri.

Vrojtimi i radhës u zhvillua gjatë muajit korrik të vitit 2008 dhe është i pesti ndër vrojtmet e ndërmarra për krijimin dhe monitorimin e bazës së të dhënave për IHD-të në Shqipëri. Ky vrojtım u zhvillua nëpërmjet anketimit në shkallë kombëtare të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët. Vlerësohet se cilësia dhe sasia e informacionit të mbledhur nëpërmjet këtij vrojtimi kanë ardhur në rritje nga viti në vit.

Materiali i mëposhtëm fillon me një përmbledhje të shkurtër të përkufizimeve dhe metodologjisë lidhur me konceptin e IHD-ve. Në këtë seksion përshkruhet metoda e ndjekur për vlerësimin e stokut të kapitalit të huaj si dhe çështje të tjera lidhur me zgjedhjen për vrojtimin.

Analiza e rezultateve të vrojtimit është ndarë në dy seksione: seksioni i parë analizon karakteristikat e përgjithshme të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët të vrojtuar (të tilla si shpërndarja sektoriale e ndërmarrjeve, origjina e tyre, përqendrimi i fuqisë punëtore etj.); ndërsa seksioni i dytë analizon karakteristikat sasiore të investimit të huaj direkt në këto ndërmarrje, në terma të stokut të kapitalit dhe investimeve.

Duke qenë se informacioni mbi vlerat nominale në lidhje me stokun e IHD-së dhe shpërndarjen e tij në Shqipëri, ende nuk është paraqitur në publikimet

zyrtare të Bankës së Shqipërisë, materiali i mëposhtëm ofron informacion vetëm mbi strukturën e investimit të huaj sipas formave, aktivitetit ekonomik dhe vendeve të origjinës.

3. MBLEDHJA E PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

3.1. METODOLOGJIA

Në përpunimin e të dhënave të marra nga ky vrojtim, për llogaritjen e stokut të investimit të huaj direkt është mbajtur parasysh përkufizimi i IHD-së dhënë në Botimin e Pestë të Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së (BPM5), sipas të cilit *investitori direkt* është pronari i 10 për qind ose më shumë të kapitalit të një ndërmarrjeje. Në bazë të kësaj përqindjeje janë zgjedhur ndërmarrjet për t'u anketuar në këtë vrojtim.

Investimi direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese midis dy palëve.

Pyetëtori për intervistimin e ndërmarrjeve është rishikuar gjatë viteve për të siguruar më shumë informacion të nevojshëm në lidhje me karakterin e investimeve të huaja në Shqipëri, e njëkohësisht për t'u bërë më i lehtë për plotësim nga të intervistuarit. Aktualisht pyetëtori përmban dy pjesë kryesore. Në rubrikën e parë kërkohet informacion rreth karakteristikave dhe elementeve të identifikimit të ndërmarrjes (si sektori ekonomik, numri i punonjësve, përqindja e kapitalit të huaj, vendi i origjinës etj.). Rubrika e dytë, kërkon informacion financiar nga pasqyrat kryesore financiare të fundvitit si bilanci kontabël dhe investimet e kryera gjatë vitit fiskal. Këto pasqyra financiare japin informacion mbi vitin fiskal aktual dhe atë paraardhës (në vrojtimin në fjalë mbi vitet fiskale 2007 dhe 2006).

3.1.1. Llogaritja e stokut të investimeve direkte

Në llogaritjen e stokut të kapitalit të huaj të investuar në Shqipëri, në gjendje në fund të vitit 2007, janë përfshirë përbërësit e mëposhtëm:

- pjesa (kontributi) e investitorit të huaj në kapitalin e nënshkruar të ndërmarrjes së vrotuar (në formën e aksioneve apo në natyrë),
- pjesa e investitorit të huaj në rezervat e ndërmarrjes (rezervat e detyrueshme ligjore si edhe të gjitha rezervat e tjera, mbajtur nga vetë ndërmarrja),
- pjesa e investitorit të huaj në fitimet (ose humbjet) e mbartura nga periudha të mëparshme dhe të riinvestuara (të pashpërndara në formë dividendi),
- pjesa e investitorit të huaj në fitimet ose humbjet e periudhës ushtrimore,
- dhe kapitalet e tjera, të cilat janë marrëdhënie detyrimesh apo

pretendimesh të ndërmarrjes së huaj në vend dhe ndërmarrjeve - mëmë apo degëve të tyre jashtë vendit.

Këto të fundit mund të jenë në formën e huamarrjeve / huadhënieve afatshkurtra ose afatgjata, direkte ose indirekte, të aksionerëve në vend ose jashtë vendit, të cilat formojnë stokun e IHD-së bashkë me elementet e kapitaleve të veta (kapitali i nënshkruar, fitimi i riinvestuar dhe ai i realizuar gjatë periudhës), siç përcaktohet në literaturën mbi investimet e huaja direkte, si edhe sipas përkufizimit për to nga FMN dhe OECD.

3.2. MBULIMI I TË DHËNAVE

Që prej kryerjes së vrojtimit të parë mbi kompanitë me kapital të huaj e të përbashkët, është punuar për krijimin e një baze të dhënash me kompanitë që rezultojnë aktive e me pjesëmarrje të kapitalit të huaj. Kjo bazë rifreskohet me të dhënat e çdo vrojtimi si edhe me të dhëna të reja nga INSTAT për kompani të reja të krijuara, që plotësojnë kushtet për të bërë pjesë në popullatën e vrojtuar.

Në vrojtimin në fjalë u anketuan 1247 kompani të regjistruara e të vendosura në 24 rrethe të vendit. Nga këto, 220 ndërmarrje ose rreth 18 për qind e popullatës, rezultuan të mbyllura, nuk gjendeshin ose refuzuan të përgjigjeshin. Nga ndërmarrjet që iu përgjigjën anketimit, 101 ishin ndërmarrje shqiptare, ndërsa 928 ndërmarrjet e tjera janë ndërmarrje të investimit të huaj direkt në sektorë financiarë jobanka.

Për të pasur një kuadër më të plotë të investimit të huaj direkt në Shqipëri, informacionit të marrë nga vrojtimi i janë shtuar edhe të dhënat financiare të 16 bankave me kapital të huaj e të përbashkët që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri. Për rrjedhojë, analiza e mëposhtme do të bazohet në të dhënat e përgjithshme dhe financiare të 944 subjekteve të të gjithë sektorëve, me kapital të huaj e të përbashkët, që operojnë në Shqipëri.


4. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË NDËRMARRJEVE TË VROJTUARA

4.1. SHPËRNDARJA NË VITE E NDËRMARRJEVE

Duhet pasur parasysh që analiza mbi moshën e ndërmarrjeve bazohet mbi ndërmarrje aktive në momentin e intervistimit, pa marrë në konsideratë ndërmarrjet që janë krijuar dhe më pas kanë ndërprerë aktivitetin e tyre gjatë këtyre viteve.

Përveç rënive në numrin e ndërmarrjeve të reja të krijuara në vitet 1997 dhe 2002 (respektivisht për

Grafik 1. Numri i ndërmarrjeve me kapital të huaj të çelura në vite.



shkak të krizës së shkaktuar prej rënies së skemave piramidale dhe krizës së Kosovës), vihet re një tendencë në rritje e numrit të ndërmarrjeve me kapital të huaj në Shqipëri. Veçanërisht i lartë paraqitet numri i ndërmarrjeve me kapital të huaj të çelura në vitin 2007, të cilat përbëjnë rreth 22 për qind të ndërmarrjeve të vrojtura.

4.2. PËRQINDJA E PJESËMARRJES SË KAPITALIT TË HUAJ

Nga këndvështrimi i pjesëmarrjes së kapitalit të huaj, ndërmarrjet e vrojtura janë dy llojesh: me kapital tërësisht të huaj ose me kapital të përbashkët. Në përgjithësi, ndërmarrjet janë më së shumti të kontrolluara nga investitorët e huaj, duke qenë se në rreth 86 për qind të tyre pjesëmarrja e kapitalit të huaj është më shumë se 50 për qind. Këto ndërmarrje, sipas përcaktimit të BPM5 quhen filiale, dhe janë në vetvete shoqëri tregtare në të cilat investitori i huaj kontrollon direkt ose indirekt (nëpërmjet një tjetër filiali), më shumë se 50 për qind të fuqisë votuese (vendimmarrëse).



Ndërkohë, në rreth 65 për qind të ndërmarrjeve të vrojtura, investuesi i huaj ka kontroll të plotë të ndërmarrjes (100 për qind kapital i huaj).

4.3. VENDI I ORIGJINËS SË NDËRMARRJEVE

Vendet e Bashkimit Evropian vazhdojnë të mbeten investuesit kryesorë në Shqipëri, me rreth 77 për qind të ndërmarrjeve me kapital të huaj. Ndër to, vendin kryesor e zë Italia me rreth 40 për qind të ndërmarrjeve të huaja në vend, e ndjekur nga Greqia me rreth 26 për qind. Afërsia gjeografike me Shqipërinë është vetëm njëri faktor që shpjegon dominimin e investitorëve nga këto dy vende. Faktor tjetër i rëndësishëm është roli kryesor që kanë Italia e Greqia ndër partnerët tregtarë të Shqipërisë, pasi pjesa më e madhe e eksporteve të vendit është e destinuar për këto vende.

Vendet e rajonit kanë investuar në rreth 13 për qind të ndërmarrjeve me kapital të huaj e të përbashkët në Shqipëri dhe përfaqësohen me Turqinë, si investuesin kryesor me 8 për qind të ndërmarrjeve. Edhe ndërmarrjet me origjinë Maqedoninë janë shtuar në numër vitet e fundit. Në përgjithësi, mund të thuhet se ndërmarrjet me kapital të huaj që kanë aktivitet në Shqipëri kanë një shtrirje të gjerë gjeografike.

Tabelë 1. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës për vitin 2007.

Vendi i origjinës	Nr. i ndërmarrjeve	Përqindje
Bashkimi Evropian	727	77
nga të cilat:		

Itali	382	40
Greqi	242	26
Gjermani	28	3
Austri	17	2
Britani	16	2
France	10	1
Vendet e rajonit	127	13
nga të cilat:		
Turqi	73	8
Maqedoni	25	3
Kosove	13	1
Kroaci	6	1
Të tjera	90	10
nga të cilat:		
Kinë	30	3
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	24	3
Egjipt	9	1
Të tjera	27	3
Total	944	100

Për një shpërndarje më të detajuar të ndërmarrjeve sipas të gjitha shteteve të origjinës, referojuni tabelës 1 në aneksin bashkëngjitur.

4.4. SEKTORËT E EKONOMISË DHE FUQIA PUNËTORE

Ndërmarrjet e intervistuar operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare dhe raportojnë një numër total prej 32,107 të punësuarish në fund të vitit 2007.

Në fund të vitit 2007, bilanci i numrit të ndërmarrjeve me kapital të huaj, është anuar lehtë nga sektori i tregtisë me shumicë dhe me pakicë, riparimit të automobilave, motoçikletave, sendeve personale dhe pajisjeve shtëpiake, të cilit i përket numri më i madh i ndërmarrjeve (rreth 33 për qind, tabela 2), dhe që përfaqësohet kryesisht nga tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar. Pavarësisht peshës së madhe në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve, ky sektor ka punësuar vetëm 6 për qind të fuqisë punëtore të ndërmarrjeve me kapital të huaj.

Industria që përgjatë viteve ka zënë në mënyrë të vazhdueshme vendin e parë për nga numri i ndërmarrjeve të huaja në Shqipëri është ajo përpunuese, e cila në fund të vitit 2007 përfaqësohej me rreth 306 ndërmarrje (ose rreth 32.4 për qind të totalit të ndërmarrjeve të intervistuar).

Brenda industrisë përpunuese, vend të rëndësishëm zë industria e tekstileve dhe e veshjeve (rreth 13 për qind të ndërmarrjeve të vrojtuar) ku është përqendruar një pjesë e mirë e kapitalit italian, në formën e ndërmarrjeve të tekstileve me fason. Analiza e të dhënave mbi numrin e të punësuarve sipas sektorëve, tregon se industria e përpunimit ka punësuar rreth 54 për qind të totalit të të punësuarve. Këto rezultate sugjerojnë që ndërmarrjet përpunuese të vendosura në vendet e BE, fqinje të Shqipërisë, kryesisht Itali, vazhdojnë të

orientohen drejt Shqipërisë për të përfituar avantazhet e kostos krahasimisht më të ulët të krahut të punës.

Tabelë 2. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

Nace	Përshkrimi	Nr. Ndërmarrjeve	%	Nr. punonjësve	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	4	0.4	72	0.2
B	Peshkimi	4	0.4	21	0.1
C	Industria nxjerrëse	19	2.0	400	1.2
D	Industria përpunuese	306	32.4	17,390	54.2
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	17	1.8	280	0.9
F	Ndërtimi	71	7.5	924	2.9
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilitave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	311	32.9	1,914	6.0
H	Hotele dhe restorantet	16	1.7	279	0.9
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	34	3.6	3,686	11.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	23	2.4	5,542	17.3
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	104	11.0	686	2.1
M	Arsimi	11	1.2	426	1.3
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	11	1.2	54	0.2
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	13	1.4	433	1.3
TOTAL		944	100.0	32,107	100.0

Me rëndësinë që ka marrë në ekonominë shqiptare, sektori i ndërtimit vitet e fundit ka tërhequr gjithnjë e më tepër vëmendjen e investitorëve të huaj. Kështu, në fund të vitit 2007 rezultojnë 71 ndërmarrje në këtë sektor (nga 44 që ishin ato në fund të vitit 2006) që përbëjnë rreth 8 për qind të numrit total të ndërmarrjeve të vrojtuar. Në të njëjtin kuadër, zhvillim ka marrë edhe sektori i pasurive të patundshme, dhënies me qira, informatikës e aktiviteteve të tjera të biznesit. Ndërmarrjet e huaja në këtë sektor përbëjnë rreth 11 për qind të ndërmarrjeve me kapital të huaj në fund të vitit 2007.

Shpërndarja e fuqisë punëtore shfaqet pak ndryshe nga ajo e numrit të ndërmarrjeve. Kështu, sektori që zë vendin e dytë për nga numri i të punësuarve është sektori i ndërmjetësimit monetar dhe financiar, i cili përfaqësohet më së shumti nga bankat tregtare. Ai ka punësuar rreth 17.3 për qind të punonjësve të raportuar dhe zë vetëm 2.4 për qind të numrit të ndërmarrjeve. Pothuajse njësoj paraqitet edhe sektori i transporteve, magazinimit dhe komunikacionit, që ka punësuar rreth 11.5 për qind të të punësuarve në ndërmarrjet e huaja.

Për një shpërndarje më analitike të klasifikimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve, referojuni tabelës 2 në aneksin bashkëngjitur.

5. KARAKTERISTIKA SASIORE TË INVESTIMIT TË HUAJ DIREKT

Stoku i kapitalit të huaj në fund të vitit 2007, i përlllogaritur sipas metodologjisë së përshkruar më sipër, për këto 944 ndërmarrje të vrojtuar

rezulton rreth 31.1 për qind më i lartë se stoku i investimit të huaj në fund të vitit 2006.

5.1. STRUKTURA E STOKUT TË KAPITALIT TË HUAJ

Pjesa më e madhe e stokut të kapitalit të huaj përbëhet nga kapitalet e veta. Kapitali i nënshkruar bashkë me rezervat dhe shtesat e kapitalit, në fund të vitit 2007 përbëjnë rreth 58 për qind të investimit të huaj në Shqipëri.


	2006	2007	Ndryshimi gjatë vitit
Kapitalet e veta	93%	95%	34%
Kapitali i nënshkruar, rezerva e prime	60%	58%	27%
Fitimi i mbartur	15%	21%	83%
Fitimi i periudhës	18%	16%	16%
Kapitale të tjera	7%	5%	-9%
Totali	100%	100%	31%

Tabelë 3. Struktura e stokut të kapitalit.

Situata e qëndrueshme makroekonomike ka siguruar një klimë të mirë investimi, që është vlerësuar e tillë edhe nga shumë investitorë të huaj. Treguesit e rentabilitetit të ndërmarrjeve kanë demonstruar rritje krahasuar me një vit më parë. Fitimi pas tatimit, i ndërmarrjeve të vrojtuar për vitin 2007 ishte rreth 16 për qind më i lartë se fitimi i raportuar në vrojtimin e një viti më parë. Edhe fitimi i mbartur nga periudha të mëparshme dhe i riinvestuar është pothuajse dyfishuar nga ai i raportuar një vit më parë, duke përbërë një bazë për formimin e besimit të investitorëve në vijueshmërinë e këtij stabiliteti ekonomik edhe në të ardhmen.

5.2. ORIGJINA E KAPITALIT TË HUAJ

Ashtu siç duket edhe nga karakteristikat cilësore të ndërmarrjeve me kapital të huaj të vrojtuar, investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian dominojnë



investimet e huaja direkte në Shqipëri. Sipas të dhënave të mbledhura nga 944 ndërmarrjet, në fund të vitit 2007 pothuaj 80 për qind e stokut të investimeve të huaja në Shqipëri ishte investim i vendeve të Bashkimit Evropian, ndër të cilët kryeson Greqia me rreth 54 për qind të kapitalit. Shpërndarja e stokut të kapitalit të ndërmarrjeve me kapital të huaj ndryshon nga ajo e numrit të ndërmarrjeve sipas vendit të origjinës, ku Italia përfaqësohet me numrin më të madh të ndërmarrjeve.

Në total, kapitali grek i investuar në Shqipëri në 242 ndërmarrje nga 944 të vrojtuar, paraqitet në fund të vitit 2007 me një rritje prej rreth 30 për qind, krahasuar me stokun e fundvitit 2006. Rreth 62 për qind e stokut të kapitalit grek në ndërmarrjet e vrojtuar është investuar në sektorin e transporteve, magazinimit dhe komunikacionit. Një sektor tjetër ku është përqendruar investimi grek është ai i ndërmjetësimit financiar e monetar me rreth 18 për qind të gjithë investimeve greke, ndjekur nga sektori i industrisë përpunuese me rreth 7 për qind.

Kapitali italian në fund të vitit 2007 paraqitet pothuaj në të njëjtën masë e përbërje si në fund të vitit 2006. Stoku me origjinë nga Italia i investuar në 382 ndërmarrje ndër ato që i janë përgjigjur vrojtimit, përbënte në fund të vitit 2007 rreth 11 për qind të totalit të investimit të huaj në vend. Dy sektorët kryesorë ku është investuar kapitali italian janë ai i ndërmjetësimit financiar e monetar dhe industria përpunuese, që zënë respektivisht 36.4 dhe 31 për qind të investimit italian në Shqipëri. Pjesa tjetër është investuar kryesisht në ndërtim (rreth 18 për qind) dhe pasuri të patundshme e të tjera aktivitete profesionale (rreth 10 për qind).

Rritje të ndjeshme këtë vit ka pasur investimi i ardhur nga Turqia, si rrjedhim i privatizimit në një sektor të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, atij të telekomunikacionit (privatizimi i Albtelekom-it). Kështu, kapitali turk në Shqipëri, në fund të vitit 2007 zë vendin e dytë për nga totali i investimit sipas vendeve të origjinës, me rreth 12 për qind të totalit të kapitalit të huaj.

Në rritje ka ardhur përgjatë këtyre viteve edhe kapitali austriak, i cili në fund të vitit 2007 raportohet të ketë arritur nivel pothuaj të njëjtë me atë italian në rreth 10.5 për qind të totalit të kapitalit të huaj. Ky kapital është kryesisht i investuar në sektorin e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, konkretisht banka tregtare dhe kompani sigurimi.

Për një pamje më të detajuar të ecurisë në vite të investimit të huaj direkt shpërndarë sipas shteteve të origjinës së kapitalit, shikoni tabelën 3 në aneksin bashkëngjitur.

5.3. SHPËRNDARJA E KAPITALIT TË HUAJ SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Sektori i transporteve, magazinimit dhe komunikacionit përfaqësohet me vetëm 4 për qind të numrit të ndërmarrjeve të vrojtuar e megjithatë, zë vendin e parë dhe një pjesë shumë të rëndësishme (rreth 41 për qind) të stokut të

kapitalit të huaj të investuar në Shqipëri, në fundin e vitit 2007. Posta dhe komunikacioni është grupi me ndikimin kryesor brenda këtij sektori, me 82 për qind të totalit të investimit në këtë sektor, dhe rreth 33 për qind të stokut total të investimit të huaj të ndërmarrjeve të vrojtuar. Në fund të vitit 2007, në krahasim me fundin e vitit 2006, stoku i kapitalit të këtij sektori në total paraqitet i rritur me rreth 35 për qind, kryesisht si rrjedhim i rritjes së fitimit të pashpërndarë e të riinvestuar dhe fitimit të periudhës, por edhe si rrjedhim i investimeve të reja në formën e privatizimeve.

Sektori i ndërmjetësimit monetar dhe financiar, gjithashtu me një numër të vogël ndërmarrjesh (rreth 2.4 për qind të gjithë ndërmarrjeve të intervistuar), zë vendin e dytë për nga stoku i kapitalit të investuar me rreth 33 për qind të stokut të kapitalit të huaj në fund të vitit 2007. Investimi në bankat tregtare, aktivitetet siguroese dhe fondet e pensionit, është rritur gjatë vitit 2007 me rreth 50 për qind, kjo pasi përveç normave të larta të rentabilitetit, gjatë vitit 2007, vijoi hyrja e kapitalit të huaj në institucionet financiare.

Tabelë 4. Shpërndarja e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

NACE	Përshkrimi	% mbi totalin
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.3
B	Peshkimi	0.0
C	Industria nxjerrëse	0.7
D	Industria përpunuese	11.0
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0.4
F	Ndërtimi	4.9
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	5.9
H	Hotele dhe restorantet	1.1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	40.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	33.0
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	0.9
M	Arsimi	0.1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.0
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	1.2
TOTAL		100.0

Megjithëse përfaqësohet me rreth 32 për qind të numrit total të ndërmarrjeve të vrojtuar dhe ka punësuar rreth 54 për qind të numrit total të punonjësve, industria përpunuese zë vetëm 11 për qind të stokut të kapitalit të huaj të këtyre ndërmarrjeve, në fund të vitit 2007.

Siç u evidentua edhe më sipër, sektori i ndërtimit ka tërhequr këtë vit një pjesë të mirë të investimeve të huaja në Shqipëri. Prezenca e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm, duke arritur kështu në rreth 5 për qind të kapitalit të huaj në Shqipëri në fund të vitit 2007.

Për të dhëna më të detajuara mbi shpërndarjen e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve ekonomikë dhe ecurinë e tij në vite, referojuni tabelave 2 dhe 4 në aneksin bashkëngjitur.

5.4. INVESTIMET GJATË VITIT USHTRIMOR 2007

Kësaj rubrike i janë përgjigjur vetëm 331 ndërmarrje që përbëjnë rreth 35 për qind të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur vrojtimit. Të dhënat e mbledhura nga këto ndërmarrje, tregojnë se totali i investimeve të kryera gjatë vitit 2007 është investuar kryesisht në mjete të trupëzuara, të cilat zënë rreth 98.6 për qind të totalit të investimeve të raportuara.

Tabelë 5. Struktura e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2007.

Investimet gjatë vitit 2007	Në % ndaj totalit
1. Të patrupëzuara	1.4
2. Të trupëzuara	98.6
2.1. Për tokë, troje, terrene	10.2
2.2. Për ndërtesa	8.9
2.3. Për ndërtime dhe instalime të përgjithshme	10.9
2.4. Për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla	35.5
2.5. Për mjete transporti	20.0
2.6. Për pajisje zyre dhe informatike	3.5
2.7. Të tjera	9.7
Totali	100.0

Pjesa më e madhe e investimeve të kryera (rreth 36 për qind) gjatë vitit ka qenë për ndërtime dhe instalime të përgjithshme, megjithatë vihen re investime më të larta gjatë vitit 2007 edhe për mjete transporti, si edhe ndërtime dhe instalime të përgjithshme. Po të analizohen sektorët e industrisë të cilëve iu përkasin ndërmarrjet që kanë raportuar investimet e mësipërme, vërehet se industria përpunuese është sektori me fluksin më të madh të investimeve gjatë vitit 2007, rreth 39 për qind të tyre, e ndjekur nga sektori i transporteve, magazinimit dhe komunikacionit me rreth 28 për qind.

Tabelë 6. Shpërndarja strukturore e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2007 sipas sektorëve të ekonomisë (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

NACE	Përshkrimi	Nr. Ndërmarrje	% mbi totalin e investuar
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	2	0.1
B	Peshkimi	2	0.0
C	Industria nxjerrëse	5	2.1
D	Industria përpunuese	166	38.5
E	Prodhimi/shpërndarje energji elektrike, gaz, avull e uji i ngrohtë	5	2.9
F	Ndërtimi	24	2.8
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	80	10.0
H	Hotele dhe restorantet	4	0.8
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	10	27.7
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	3	3.8
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	20	4.3
M	Arsimi	3	2.9
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	3	0.6
O	Aktivitetet të tjera të shërbimit social dhe individual	4	3.5
TOTAL		331	100.0

6. KONKLUZIONE

Në vërtetimin mbi investimet e huaja direkte të vitit fiskal 2007, kryer gjatë korrikut 2008, mbi 1247 ndërmarrje të vendosura në 24 rrethe të Shqipërisë, u evidentuan si ndërmarrje aktive me kapital të huaj ose të përbashkët dhe iu përgjigjën anketave 944 ndërmarrje (përfshirë bankat tregtare).

- Vihet re një rritje e vazhdueshme e numrit të ndërmarrjeve me kapital të huaj, që prej vitit 2002 dhe në pjesën më të madhe të tyre, investitorët e huaj kanë pjesën kontrolluese të kapitalit: në rreth 86 për qind të ndërmarrjeve më shumë se 50 për qind e kapitalit është i huaj dhe në 65 për qind të tyre, investuesi i huaj ka kontroll të plotë të ndërmarrjes (100 për qind kapital i huaj).
- Vendet e BE-së vazhdojnë të mbeten investueset kryesore në Shqipëri, me rreth 77 për qind të ndërmarrjeve me kapital të huaj, ku vendin kryesor e zë Italia me rreth 40 për qind të ndërmarrjeve të huaja, e ndjekur nga Greqia me rreth 26 për qind.
- Numri total i të punësuarve të ndërmarrjeve të vrojtuar, në fund të vitit 2007 është 32,107 dhe pjesa më e madhe e tyre janë punësuar në industrinë përpunuese (rreth 54.2 për qind) dhe në sektorin e ndërmjetësimit financiar e monetar (rreth 17.3 për qind).
- Pjesa më e madhe ndërmarrjeve të vrojtuar (rreth 33 për qind) i përket sektorit të tregtisë me shumicë dhe me pakicë. Sektori i dytë për nga numri i ndërmarrjeve është ai i industrisë së përpunimit, me rreth 32.4 për qind të ndërmarrjeve.
- Stoku i kapitalit të huaj për vitin 2007 për ndërmarrjet e vrojtuar rezulton rreth 31 për qind më i lartë se stoku i vitit 2006. Pothuaj 80 për qind e stokut të investimeve të huaja në Shqipëri ishte investim i vendeve të BE-së, ku kryeson Greqia me rreth 54 për qind të kapitalit e ndjekur nga Turqia dhe Italia me 12 dhe 11 për qind respektivisht. Kapitali grek është investuar në Shqipëri, në 242 ndërmarrje nga ato të vrojtuar, kryesisht (rreth 62 për qind) në sektorin e transporteve, magazinimit dhe komunikacionit.
- Stoku i kapitalit italian është investuar në 382 ndërmarrje me kapital të huaj e të përbashkët në Shqipëri. Investitorët italianë kanë preferuar kryesisht sektorin e ndërmjetësimit financiar e monetar dhe industrinë përpunuese, që zënë respektivisht 36.4 dhe 31 për qind të investimit italian në Shqipëri.
- Nga këndvështrimi i sektorëve ekonomikë, 41 për qind e stokut të kapitalit të huaj është investuar në sektorin e transporteve, magazinimit dhe komunikacionit, përfaqësuar kryesisht nga grupi 'Posta dhe komunikacioni'.
- Pothuaj të gjitha investimet e raportuara nga 331 ndërmarrjet e vrojtuar, të kryera gjatë vitit 2007, kanë shkuar për mjete të trupëzuara, kryesisht për ndërtime dhe instalime të përgjithshme.

ANEKS: TABELA STATISTIKORE

Tabelë 1. Shpërndarja e ndërmarrjeve dhe totalit të investimit të huaj sipas shteteve të origjinës. (Në %, në 31 dhjetor 2007.)

Shteti	Nr. i ndërmarrjeve	%	% mbi stokun total IHD
Arabi Saudite	5	0.5	1.0
Austri	17	1.8	10.5
Belgjikë	4	0.4	0.0
Britani	16	1.7	0.3
Bullgari	9	1.0	0.9
Danimarkë	1	0.1	0.0
Egjipt	9	1.0	0.7
Francë	10	1.1	1.4
Gjermani	28	3.0	3.5
Greqi	242	25.6	52.7
Holandë	6	0.6	0.3
Hungari	5	0.5	0.0
Institucione ndërkombëtare	1	0.1	0.7
Itali	382	40.5	10.9
Izrael	5	0.5	0.0
Kanada	2	0.2	0.0
Karaibe	1	0.1	0.0
Kinë	30	3.2	0.1
Kosovë	13	1.4	0.2
Kroaci	6	0.6	0.1
Kuvajti	1	0.1	0.0
Liban	4	0.4	0.9
Mal i Zi	4	0.4	0.0
Malajzi	1	0.1	0.6
Maqedoni	25	2.6	0.3
Rumani	3	0.3	0.2
Serbi	3	0.3	0.0
Slloveni	5	0.5	0.0
Suedi	2	0.2	0.0
Turqi	73	7.7	12.1
SHBA	24	2.5	2.3
Zvicër	7	0.7	0.1
Total	944	100.0	100.0

Tabelë 2. Shpërndarja e ndërmarrjeve dhe totalit të investimit të huaj sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT). (Në %, në 31 dhjetor 2007.)

NACE	PËRSHKRIMI	Nr. Ndërm.	%	% mbi stokun total IHD
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	4	0.4	0.3
01	Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese	4	0.4	0.3
B	Peshkimi	4	0.4	0.0
05	Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin	4	0.4	0.0
C	Industria nxjerrëse	19	2.0	0.7
CA	Nxjerrja e mineraleve energjitike	3	0.3	0.0
10	Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve; nxjerrja e torfës	1	0.1	0.0
11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	2	0.2	0.0
CB	Nxjerrja e mineraleve joenergjitike	16	1.7	0.7
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	5	0.5	0.5
14	Industri të tjera nxjerrëse	11	1.2	0.2

NACE	PËRSHKRIMI	Nr. Ndërm.	%	% mbi stokun total IHD
D	Industria përpunuese	306	32.4	11.0
DA	Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit	22	2.3	1.9
15	Industria ushqimore dhe e pijeve	20	2.1	1.8
16	Industria e duhanit	2	0.2	0.1
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	119	12.6	1.2
17	Industria e tekstileve	8	0.8	0.0
18	Industria e veshjeve dhe e gëzofëve	111	11.8	1.2
DC	Industria e lëkurës dhe e këpucëve	39	4.1	1.2
19	Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve	39	4.1	1.2
DD	Punimet me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri	14	1.5	0.1
20	Industria e drurit dhe e artikujve me dru përveç fabrikimit të mobilie, shportarisë dhe të xunkthit	14	1.5	0.1
DE	Fabrikimi i brumit të letres, i letres dhe i artikujve prej letre; shtypshkronja dhe botimi	17	1.8	0.1
21	Fabrikimi i brumit të letres, i letres dhe artikujve prej letre dhe kartoni	11	1.2	0.1
22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	6	0.6	0.0
DG	Industria kimike	4	0.4	0.0
24	Industria kimike	4	0.4	0.0
DH	Industria e gomës dhe e plastikës	12	1.3	1.5
25	Industria e gomës dhe e plastikës	12	1.3	1.5
DI	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	21	2.2	1.2
26	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë dhe jometalikë	21	2.2	1.2
DJ	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	15	1.6	1.5
27	Siderurgjia	1	0.1	1.0
28	Punime me metale	14	1.5	0.5
DK	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	3	0.3	0.0
29	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	3	0.3	0.0
DL	Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe optike	15	1.6	1.1
31	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve elektrike	9	1.0	1.1
32	Fabrikimi i aparaturave radiotelevizive dhe i atyre të komunikacionit	1	0.1	0.0
33	Fabrikimi i pajisjeve mjekësore, të precizonit, instrumenteve optike dhe orëve	5	0.5	0.0
DM	Fabrikimi i mjeteve të transportit	2	0.2	0.8
35	Fabrikimi i mjeteve të tjera të transportit	2	0.2	0.8
DN	Industri të tjera përpunuese	23	2.4	0.4
36	Fabrikimi i mobilie, industri të ndryshme	21	2.2	0.4
37	Grumbullimi dhe përgatitja për riciklim	2	0.2	0.0
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	17	1.8	0.4
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	12	1.3	0.1
41	Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	5	0.5	0.3
F	Ndërtimi	71	7.5	4.9
45	Ndërtimi	71	7.5	4.9
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	311	32.9	5.9
50	Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilave dhe motoçikletave	23	2.4	1.2
51	Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar(përveç mjeteve të transportit automobilistik)	237	25.1	4.0

NACE	PËRSHKRIMI	Nr. Ndërm.	%	% mbi stokun total IHD
52	Tregtia me pakicë ; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiakë	51	5.4	0.7
H	Hotele dhe restorante	16	1.7	1.1
55	Hotele dhe restorante	16	1.7	1.1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	34	3.6	40.5
60	Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubacioneve	5	0.5	0.2
61	Transporti ujor	2	0.2	0.0
62	Transporti ajror	2	0.2	0.0
63	Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjencive të udhëtimit	16	1.7	1.8
64	Postat dhe komunikacionet	9	1.0	38.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	23	2.4	33.0
65	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguroese si dhe fondeve të pensionit	18	1.9	31.6
66	Aktivite siguroese dhe të fondeve të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme	5	0.5	1.4
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	104	11.0	0.9
70	Aktivite të pasurive të patundshme	27	2.9	0.5
72	Aktivite informatike dhe aktivitete të lidhura me to	8	0.8	0.0
73	Kërkime-aplikime eksperimentale	4	0.4	0.0
74	Aktivite të tjera profesionale	65	6.9	0.3
M	Arsimi	11	1.2	0.1
80	Arsimi	11	1.2	0.1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	11	1.2	0.0
85	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	11	1.2	0.0
O	Aktivite të tjera të shërbimit social dhe individual	13	1.4	1.2
90	Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme	2	0.2	-0.1
91	Aktivite të organizatave të ndryshme shoqërore	1	0.1	0.0
92	Aktivite dëfrimi, kulturore dhe sportive	5	0.5	1.3
93	Aktivite të shërbimeve personale	5	0.5	0.0
Total		944	100.0	100.0

Tabelë 3. Stoku i investimit të huaj direkt në Shqipëri sipas shteteve të origjinës (Në % mbi stokun total të IHD-së, në fund të periudhës).

Shteti	2004	2005	2006	2007
Arabi Saudite	1.0	1.5	1.0	1.0
Austri	5.7	5.4	9.1	10.5
Belgjikë	0.0	0.0	0.0	0.0
Britani	0.3	0.4	0.3	0.3
Bullgari	1.4	1.1	0.8	0.9
Çeki	0.0	0.0	0.0	0.0
Danimarkë	0.0	0.0	0.0	0.0
Egjipt	1.0	0.1	0.0	0.7
Francë	0.1	0.4	1.2	1.4
Gjermani	1.5	3.4	2.8	3.5
Greqi	55.9	55.1	53.0	52.7
Holandë	0.1	0.1	0.2	0.3
Hungari	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucione ndërkombëtare	2.8	0.5	0.4	0.7
Itali	12.9	11.6	11.2	10.9
Izrael	0.0	0.0	0.0	0.0
Kanada	0.3	2.1	3.8	0.0
Karaiibe	0.0	0.0	0.0	0.0
Kinë	0.0	0.1	0.1	0.1
Kosovë	1.3	1.2	0.2	0.2

Shteti	2004	2005	2006	2007
Kroaci	1.3	0.3	0.2	0.1
Kuvajti	1.5	1.0	0.7	0.0
Liban	0.8	2.9	2.3	0.9
Luksemburg	0.0	0.0	0.0	0.0
Mal i Zi	0.0	0.0	0.0	0.0
Malajzi	1.4	0.9	0.7	0.6
Maqedoni	0.0	1.3	1.2	0.3
Qipro	0.0	0.1	0.1	0.0
Rumani	0.0	0.0	0.0	0.2
Serbi	0.0	0.0	0.0	0.0
ShBA	4.9	3.8	3.6	2.3
Siri	0.0	0.0	0.0	0.0
Sloveni	0.0	0.0	0.0	0.0
Suedi	0.0	0.0	0.0	0.0
Turqi	4.4	5.6	5.7	12.1
Zvicër	1.2	1.1	1.3	0.1
Total	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabelë 4. Stoku i investimit të huaj direkt në Shqipëri sipas sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT). (Në % mbi stokun total të IHD-së, në fund të periudhës).

Nace	Përshkrimi	2004	2005	2006	2007
		%	%	%	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.4	0.8	0.7	0.3
B	Peshkimi	0.0	0.0	0.0	0.0
C	Industria nxjerrëse	0.8	2.9	4.6	0.7
D	Industria përpunuese	25.6	14.2	12.8	11.0
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0.1	1.0	0.0	0.4
F	Ndërtimi	4.0	3.5	3.4	4.9
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	6.8	7.4	7.3	5.9
H	Hotele dhe restorantet	2.1	1.7	1.3	1.1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	26.1	41.1	39.4	40.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	31.0	26.0	28.9	33.0
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	2.3	1.1	1.3	0.9
M	Arsimi	0.1	0.1	0.1	0.1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.1	0.0	0.0	0.0
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	0.6	0.1	0.1	1.2
TOTAL		100.0	100.0	100.0	100.0

SHËNIME

* Endrita Xhaferaj, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë.

¹ Në material do të përdoret IHD.